



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-120

Prishtinë, më 15 korrik 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 KORRIK 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 korrik 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 korrik 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 korrik 2013.

Ndërkaq, nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, bëri vërejtje në transkript, në faqen 7, që është përmirësuar sipas vërejtjes së tij.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy seanca dhe atë:

Mbledhja plenare më 18 korrik 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kimikate,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e punësimit në Republikën e Kosovës,*
7. *Shqyrtimi i propozimit për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e tetë (8) të projektligjeve që kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave,*

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës
9. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar,
10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media,
11. Propozimi i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtares në Komisionin për Integritet Evropian,
12. Debat parlamentar lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit, sipas kërkesës së deputetit Kurtan Kajtazi, mbështetur nga deputetët nënshkrues.

Mbledhja plenare më 18 korrik 2013, në orën 15:30, me këtë:

Rend dite

1. Adresimi i komisionarit të Unionit Evropian për Zgjerim, z. Stefan Fule, para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian për miratimin e projektligjeve për përmbushjen e kriterëve që dalin nga procesi i liberalizimit të vizave

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit; Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, dhe Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, këtë pikë e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 18 korrik 2013.

2. Kërkesa e deputetit Kurtan Kajtazi, mbështetur nga deputetët nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, i Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit

Kryesia, pasi diskutoi për çështjen e lartshënuar, këtë pikë e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 18 korrik 2013.

3. Kërkesa për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartshënuar, këtë pikë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të datës 18 korrik 2013, në orën 10:00, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 18 korrik 2013, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet si në vijim: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP i KKR-së 1 anëtar, GP SLS 1 anëtar, GP ZB 1 anëtar dhe GP "6+" 1 anëtar.

4. Njoftim lidhur me listën e anëtarëve të Grupit të Miqësisë të Parlamentit Saudit me Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia u njoftua me formimin e Grupit të Miqësisë të Parlamentit Saudit me Kuvendin e Republikës së Kosovës, si dhe me listën e anëtarëve të këtij grupi të miqësisë.

5. Njoftimi i deputetes Alma Lama për tërheqjen nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje"

Kryesia, në bazë të nenit 20 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, u njoftua nga deputetja Alma Lama se ajo prej datës 10 korrik 2013 është tërhequr nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe se në të ardhmen do të veprojë si deputete e pavarur.

6. Propozimi i GP të Lëvizjes "Vetëvendosje" për zëvendësimin e anëtares në Komisionin për Integritet Evropian

Kryesia, propozimin e lartshënuar e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 18 korrik 2013.

7. Informatë për gjendjen në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi

Kryesia, çështjen e lartcekur e shtyu përsëri për mbledhjen e radhës, me qëllim të analizimit të raportit të Komisionit për konstatimin e gjendjes në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi dhe përgatitjes së një rekomandimi për mbledhjen plenare të radhës.

Pika shtesë:

1. Miratimi i shpenzimeve lidhur me organizimin e takimit të dhjetë jubilar të Evropës Juglindore të Lutjeve të Mëngjesit, të mbajtur në Kosovë prej 24-26 maj 2013

Kryesia, pasi e shqyrtoi çështjen e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohej kërkesa për mbulimin e shpenzimeve lidhur me organizimin e takimit të dhjetë jubilar të Evropës Juglindore të Lutjeve të Mëngjesit, të mbajtur në Kosovë prej datës 24-

26 maj 2013, në shumën prej 33 029,09 euro nga shuma e përgjithshme e vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 04/354, datë 20 maj 2013.

Të ndryshme:

Kryetari i GP të ZB-së, z. Goran Marinković, ripërsëriti kërkesën për krijimin e kushteve dhe të zyrave të punës për këtë grup parlamentar.

Kryetari kërkoi nga Administrata e Kuvendit që të krijojë kushte të punës dhe hapësirë të zyrës në Kuvend për Grupin Parlamentar të ZB-së.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale